



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 728 Akti

Nr. 653 Vendimi
Tiranë, më 28.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 26.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ermal Tauzi**, me funksion këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi, me funksion këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, është subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2021, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të

¹ Akt përfundimi i kontrollit me nr. *** prot., datë 6.2.2018.

Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar: *Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi.*

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi.

11. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 13.4.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.4.2023, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 18.4.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave në datën 20.4.2023.

14. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 24.4.2023.

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datë 26.4.2023, ora 10:00, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë.

17. Subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Ermal Tauzi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr. ***, datë 31.10.2017.

18.1 Subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova e shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.5 Por, referuar vendimit nr. 2/2017³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

19.6 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti pranë ILDKPKI-së me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti pranë ILDKPKI-së; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato dhëna gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

³ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

20. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive.

20.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi.

20.2 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijon:

- i) pasuri në përdorim, apartament banimi me sipërfaqe 87.5 m², ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, blerë nga prindërit e tij në vitin 1993 kundrejt çmimit 20,975 lekë – pasuri kjo e deklaruar edhe nga babai i tij në cilësinë e personit të lidhur;
- ii) gjendje e llogarisë rrjedhëse në datën 31.12.2016, në shumën 27,000 lekë;
- iii) gjendje likuiditetesh *cash* në shumën 100,000 lekë, me burim kursimet e subjektit.

20.3 Gjithashtu, rezulton se babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, krahas deklaramit të bërë mbi pronësinë e apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, ka deklaruar se disponon veçmas pasurinë e llojit “likuiditet në gjendje *cash*”, në shumën 700,000 lekë, me burim kursimet prej të ardhurave nga pagat ndër vite.

Hetimi i kryer nga Komisioni/verifikimi i mënyrës së përfitimit dhe burimit të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të

21. Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes së hetimit administrativ⁴, Komisioni konstaton se apartamenti i banimit i sipërcituar është përfituar nga prindërit e subjektit nëpërmjet ligjit të privatizimit të banesave shtetërore, e konkretisht duke u nënshkruar në korrik të vitit 1993 kontrata e shitblerjes⁵ së kësaj pasurie me Ndërmarrjen Komunale Banesa nr. ***, Tiranë, periudhë në të cilën rezulton se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi ka qenë i mitur.

21.2 Ndërsa, lidhur me pasuritë e llojit “likuiditete”, bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të cilat justifikojnë plotësisht krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash*, të deklaruara prej tyre në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

21.3 Në vijim të verifikimit të deklaratimeve të bëra nga subjekti, në raport me të dhënat e rezultuara në dokumentacionin e përfutur gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë së pagës, si dhe nuk ka deklaruar një llogari tjetër bankare, të quajtur *visa prepaid internet*. Por, gjithsesi evidentohet se këto llogari kanë qenë me gjendje në vlera minimale, madje njëra me balancë negative, në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin “Detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar marrjen e huas në formë *overdraft*-i pranë “Credins Bank” dhe shumën totale limit të cilën mund të përdorte⁷.

⁴ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, ndodhur aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2018, të ZVRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së hetimit të ILDKPKI-së.

⁵ Kontratë shitjeje datë 8.7.1993, konfirmuar me dokumentin noterial “vërtetim nënshkrimi”, redaktuar nga noteri publik, znj. M.S.

⁶ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneks nr. 1, pjesë e këtij vendimi.

⁷ Rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* llogaria e pagës së subjektit në “Credins Bank” ka qenë në vlerë negative në shumën -59,894 lekë, si rrjedhojë e *overdraft*-it të marrë në datën

21.4 Bazuar në kuadrin ligjor që lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni vlerëson se të gjithë personat të cilët për periudhën e rivlerësimit kanë qenë në certifikatën e përbërjes familjare me subjektin e rivlerësimit, kanë pasur detyrimin të plotësonin dhe dorëzonin deklaratën veçmas të interesave privatë, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

21.5 Në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se “person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

21.6 Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

21.7 Ndërsa, në pikën 1 të nenit 31 dhe pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se:

- Neni 31/1 i ligjit 84/2016: *“Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së”*.

- Neni 32/1 i ligjit 84/2016: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

21.8 Gjithashtu, në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës është përcaktuar se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

21.9 Në pikën 12 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se “periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij sipas këtij ligji.

21.10 Në vijim, në pikën 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, është parashikuar se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

21.11 Për sa më sipër, ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016. Si rrjedhojë, periudha e rivlerësimit për efekt të këtij ligji është nga data 8.10.2013 deri në datën 8.10.2016.

21.12 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të administruar në dosje⁸, Komisioni vëren se në periudhën e rivlerësimit, përgjatë kohës që subjekti ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese, kishte në përbërje familjare babain, nënën dhe vëllain, të cilët për efekt të ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se kanë pasur detyrimin për deklarimin e pasurive dhe të interesave të tjerë privatë.

13.10.2016 (referohuni dokumentacionit bankar të depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Credins Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2021).

⁸ Certifikatë familjare nr. ***, depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe informacionin/dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Kontrollit në Ministrinë e Brendshme, me shkresën nr. *** prot., datë 13.3.2023.

21.13 Nga analizimi në harmoni i dispozitave të mësipërme me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se prindërit dhe vëllai i subjektit bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjerë privatë.

21.14 Por, rezulton se me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* nuk janë depozituar deklarime veçmas mbi pasuritë, të ardhurat, detyrimet etj. për personat e lidhur, nënën dhe vëllain e subjektit. Konstatohet se ky detyrim është përmbushur vetëm nga babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe interesave të tjerë privatë, për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar.

21.15 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka pyetur⁹ subjektin në lidhje me arsyet e mosplotësimit të deklaratës *Vetting* nga personat e lidhur, nëna dhe vëllai i tij, duke i kërkuar gjithashtu deklarimin e pasurive të tyre dhe depozitimim e dokumentacionit justifikues ligjor lidhur me to.

21.16 Në lidhje me mosplotësimin e deklaratës nga nëna e tij, subjekti ka deklaruar se *mosplotësimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar nga nëna e tij ka qenë një lapsus që ka ardhur si pasojë e mungesës së informacionit prej tyre të mënyrës së plotësimit dhe nënshkrimit të saj, duke mos qenë asnjëherë më parë subjekte që kanë deklaruar pasurinë. Me nënshkrimin e babait si kryefamiljar është konsideruar prej tyre i plotësuar detyrimi ligjor dhe dhënia e autorizimit për verifikimin e sa kanë deklaruar në atë deklaratë. Kjo është arsyeja e vetme pse deklarata nuk është kundërfirmosur edhe nga nëna e tij.*

21.17 Ndërsa, në lidhje me mosplotësimin e deklaratës nga ana e të vëllait, subjekti ka deklaruar se *ka qenë një gabim njerëzor në situatën që vëllai i tij që prej vitit 2010 e në vijim ka jetuar i shkëputur nga familja, pra nuk ka jetuar në banesën e familjes dhe nuk ka qenë më pjesë e ekonomisë familjare të përbashkët, duke mos kontribuar më në familje dhe, për më tepër, as duke përfituar nga pasuria e familjes. Që prej vitit 2010 ai ka pasur të ardhura dhe shpenzimet e tij personale që nuk janë bërë pjesë e pasurisë së familjes. Fakti që ai ishte ende pjesë e trungut familjar për vitet në vijim ka ardhur si pasojë e neglizhencës në pasqyrimin e kësaj situatë faktike edhe në regjistrat e gjendjes civile ...duke informuar se në muajin shtator të vitit 2017 është bërë ndarja nga trungu i familjes dhe që prej atij momenti ai dhe vëllai i tij figurojnë të vetëm në certifikatën familjare.*

21.18 Më tej, subjekti ka sqaruar se, për sa i përket deklarimit të pasurive, nëna e tij është bashkëpronare vetëm në pasuritë e deklaruara nga babai në masën 50% pjesë takuese, ndërsa për vëllain e tij E.T ka deklaruar se *E.T për periudhën së cilës i referohet deklarata e rivlerësimit kalimtar nuk ka pasur asnjë pasuri të paluajtshme ose të luajtshme. Ai që prej vitit 2004 dhe deri në periudhën e deklarimit ka qenë i punësuar në T.K.O.B dhe A.P, ka pasur të ardhurat e tij personale nga paga dhe kursime personale. Rithekson se që prej vitit 2010 ai nuk ka kontribuar dhe as ka përfituar nga/dhe në pasurinë familjare ose pasurinë e tij si subjekt rivlerësimi...*

22. Komisioni kreu hetime mbi personat e lidhur¹⁰, nga ku rezultoi se, krahas pjesës takuese për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë (zotëruar nga nëna e subjektit si pasuri e përbashkët me bashkëshortin, babain e subjektit), deklaruar si pasuri nga subjekti dhe babai i tij në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ata nuk kanë pasur në emër të tyre pasuri të tjera të luajtshme apo të paluajtshme të regjistruara në regjistrat publikë,

⁹ Shihni pyetësoin nr. ***.

¹⁰ Referohuni dokumenteve: (i) vërtetim negativ/pozitiv për të gjithë territorin sipas kërkesave nr. *** dhe nr. ***, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD); (ii) shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2021, e DPSHTRR-së; si dhe (iii) verifikimeve të tjera të kryera (kërkesave të bëra nga Komisioni dhe shkresave kthim përgjigjeje nga institucione publike), pjesë e dosjes së hetimit administrativ.

përveç disa llogarive bankare me gjendje minimale dhe me burim krijimi të ardhura të kredituara nga paga/pensioni, të pasqyruara si vijon:

22.1 “Credins Bank”¹¹ konfirmon se në emër të nënës së subjektit, znj. J.T, figuron një llogari në të cilën i kreditohet pensioni i pleqërisë, me gjendje në datën 24.1.2017 (momenti i dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit) në vlerën 26,269 lekë. Gjithashtu, kjo bankë konfirmon se në emër të vëllait të subjektit, z. E.T, figuron një llogari rrjedhëse, me gjendje në datën 24.1.2017 në vlerën 554 lekë.

22.2 “Raiffeisen Bank”¹² konfirmon se në emër të vëllait të subjektit, z. E. T, figuron një llogari në të cilën i kreditohet paga, me balancë në datën 24.1.2017 në vlerën 10,828 lekë. Gjithashtu, konfirmohet se vëllai i subjektit ka pasur një kredi konsumatore pranë kësaj banke në shumën 88,000 lekë, të disbursuar në datën 19.1.2012, e cila rezulton të jetë shlyer gjatë viteve 2012 – 2013, si dhe një kredi në shumën 96,990 lekë, të disbursuar në datën 22.1.2016, të shlyer gjatë viteve 2016 – 2020¹³.

22.3 Gjithsesi, për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e tij përfundimtare/shteruese mbi arsyet e mosplotësimit dhe dorëzimit bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të deklaratave të interesave privatë të personave të lidhur (deklaratat e pasurive veçmas), nënës dhe vëllait, në përmbushje të detyrimit ligjor dhe kushtetues, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të nenit 3, nenin 30, pikën 1 të nenit 31, pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

23. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancat dëgjimore, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar, ndër të tjera, sa vijon:

23.1 *Së pari, në lidhje me prindërit e tij, Z.T dhe J. T, referuar deklaratës Vetting të datës 24.1.2017, në lidhje me personat e lidhur, siç konstatohet, ka plotësuar dhe deklaruar pasurinë e dy prindërve të tij, pra edhe të nënës. Në faqen *** të kësaj deklarate pasuria e deklaruar, konkretisht apartamenti dhe gjendja cash e krijuar nga pagat, është pasuri e dy prindërve të tij (në pjesë të barabarta me nga 50% secili) dhe e deklaruar prej tyre. Po të vijohet edhe më tej, konkretisht në faqen *** të së njëjtës deklaratë, konstatohet se është deklaruar edhe shuma e pensionit mujor të cilën e përfitonte nëna e tij në momentin e deklarimit. Në vijim, subjekti deklaroi se konstatimi i Komisionit për mungesën e nënshkrimit të saj në këtë deklaratë është i drejtë, por kjo është një neglizhencë e deklaruesve (prindërve të tij), ashtu sikurse edhe e tij, që nuk ka verifikuar saktësinë e plotësimit të saj. Referon se ky është një lapsus që ka ardhur si pasojë e mungesës së informacionit prej tyre (prindërve) në lidhje me mënyrën e plotësimit dhe nënshkrimit të deklaratës, duke qenë se nuk përfshihen në rrethin e subjekteve që kanë detyrimin për deklarim, për rrjedhojë nuk kanë deklaruar më parë dhe nuk kanë plotësuar më parë deklarata të pasurisë. Subjekti argumenton se me nënshkrimin e babait si kryefamiljar është konsideruar prej tyre i plotësuar detyrimi ligjor dhe dhënia e autorizimit për verifikimin e atyre që janë deklaruar. Kjo është arsyeja e vetme pse deklarata nuk është kundërfirmosur edhe nga nëna e tij, pa pasur asnjë arsye tjetër, duke qenë se të dhënat dhe të ardhurat, pra pasuritë, janë plotësuar për secilin prej tyre.*

23.2 *Së dyti, në lidhje me vëllain e subjektit, z. E. T, i cili në atë kohë ka qenë i regjistruar në përbërjen familjare, mosdeklarimi i tij është sërish një gabim njerëzor, neglizhencë e tij që nuk ka verifikuar gjendjen e përbërjes familjare në atë kohë. Kjo ka ardhur si pasojë e faktit se*

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.8.2021, e “Credins Bank”.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2021, e “Raiffeisen Bank”.

¹³ Për efekt të analizës financiare të kryer nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi janë përlogaritur të gjitha shpenzimet për shlyerjen e kredive të vëllait të tij si person i lidhur për vitet 2011 – 2016.

vëllai i tij që prej vitit 2010 e në vijim ka jetuar i shkëputur nga familja, pra nuk ka jetuar në banesën e familjes dhe nuk ka qenë pjesë e ekonomisë familjare të përbashkët, duke mos kontribuar më në familje dhe, për më tepër, as duke përfitur nga pasuria e familjes. Që prej vitit 2010 ai ka pasur të ardhura dhe shpenzime të tij personale, që nuk janë bërë pjesë e pasurisë së familjes. Megjithatë, edhe pse faktikisht i shkëputur nga familja, ai nuk ka bërë edhe formalisht shkëputjen nga trungu familjar dhe regjistrimin më vete në regjistrat e gjendjes civile deri në muajin shtator të vitit 2017, moment prej të cilit ata (subjekti dhe i vëllai) kanë bërë ndarjen nga trungu i familjes dhe secili rezultoi i vetëm në certifikatën familjare. Megjithatë, subjekti referon se e ka konsideruar si pjesëtar të familjes në kuptim të deklaramit për parandalimin e konfliktit të interesave. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, datë 20.2.2023, me email-in e datës 24.2.2023, ka paraqitur të gjitha të dhënat në lidhje me pasurinë e vëllait dhe autorizimin për verifikimin e tyre.

Vlerësimi/qëndrimi përfundimtar i Komisionit

24. Pas analizimit dhe shqyrtimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues i qëndron konstatimit fillestar, duke vlerësuar se mosdorëzimi së bashku me deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të deklaratave veçmas të interesave privatë të personave të lidhur, nënës dhe vëllait, e çon në kushtet e deklaramit të pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

25. Gjithsesi, në kushtet kur nga hetimi i kryer rezultoi se personat e lidhur, nëna dhe vëllai i subjektit, nuk dispononin pasuri veçmas të luajtshme dhe/apo të paluajtshme të regjistruar në regjistrat publikë, por vetëm gjendje të vogla likuiditetesh në llogaritë bankare ku i kreditohej pensioni apo paga dhe, në këtë kontekst, rezultoi e provuar se ky mosdeklarim nuk lidhet me mungesë burimesh financiare për justifikimin e krijimit të pasurive nga personat e lidhur, trupi gjykues konkludon se kjo pasaktësi në deklaram nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare

26. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi është emëruar në funksionin e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese në datën 25.3.2016, detyrë e cila e ka përfshirë në rrethin e subjekteve të rivlerësimit për efekt të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të bëra në nenin 179/b, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës (detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht). Nga ana tjetër, rezultoi se z. Ermal Tauzi për periudhën shtator 2011 – mars 2016 ka ushtruar funksionin e këshilltarit ligjor në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, funksion i cili e bënte subjekt deklarames të pasurisë dhe interesave privatë në ILDKPKI.

26.1 Për sa më sipër, në kushtet kur çmohet se për efekt të këtij procesi rëndësi ka edhe verifikimi i të shkuarës së subjektit të rivlerësimit, e aq më tepër në këtë rast kur ai ka ushtruar një funksion publik dhe ka qenë subjekt që mbartte detyrimin për deklaramin e pasurisë, trupi gjykues vlerësoi që analiza financiare të kryhet për gjithë periudhën që z. Ermal Tauzi ka qenë subjekt deklarames në ILDKPKI e deri në momentin e dorëzimit të deklarames së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

26.2 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 19.9.2011¹⁴ – 31.12.2011 dhe për vitet 2012 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaramuara apo të evidentuara nga Komisioni përgjatë kësaj periudhe¹⁵.

¹⁴ Data e emërimit si këshilltar ligjor në Kuvendin e Shqipërisë.

¹⁵ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneksit nr. 1, pjesë e këtij vendimi.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

27. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

28. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit.

29. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

30. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

30.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës¹⁶ së subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

30.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi.

30.3 Komisioni ka kërkuar nga DSIK-ja¹⁷ përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi. DSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit, pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt.

30.4 Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi në veprimtari të kundërligjshme.

30.5 Në këtë kontekst, DSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi, por me vendimin nr. ***, datë 16.3.2023, të KDZH-së, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

¹⁶ Raporti mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 31.10.2017.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2023, e Komisionit.

30.6 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

31. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

32. Në përputhje me pikën 2 të nenit 42 të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk është magjistrat, vlerësohet bazuar në: (i) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe (ii) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

32.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në procedurat e përcaktuara për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, ka përgatitur raportin për analizimin e aftësisë profesionale¹⁸ të subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore.

32.2 Referuar këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e tij në të drejtën kushtetuese, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ai ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit si këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese. Duket se subjekti i rivlerësimit Ermal Tauzi ka përballuar me efikasitet ngarkesën e punës dhe rezulton se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

32.3 Shkolla e Magjistraturës ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi, ku nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “testi elektronik”, subjekti është vlerësuar me 40 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “testi profesional” është vlerësuar me 135 pikë nga 200 pikë të mundshme.

32.4 Gjithashtu, nga verifikimi i regjistrit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar ankesa nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi.

32.5 Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur dokumentet ligjore, si dhe të dhënat e tjera mbi bazën e të cilave vlerësohen këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese për efekt të këtij procesi, nga ku rezulton se nuk konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit Ermal Tauzi.

¹⁸ Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi, me nr. *** prot., datë 22.2.2023.

Konkluzion i Komisionit për kriterin e vlerësimit profesional

33. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ermal Tauzi, këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 28.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS NR. 1
TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE
PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ERMAL TAUZI

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 19.9.2011-31.12.2011 si dhe për vitet 2012,2013,2014,2015 dhe 2016	19.9.2011-31.12.2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	18,655	35,734	564,752	(612,377)	(116,276)	944,254
Ndryshim likuiditeti	18,655	35,734	564,752	(612,377)	(116,276)	944,254
B) Detyrime	61,512	88,000	-	-	-	96,990
Kredi konsumatore E. T		88,000				96,990
Kredi konsumatore Ermal Tauzi	61,512					
C) Pasuri neto (A-B)	(42,857)	(52,266)	564,752	(612,377)	(116,276)	847,264
D) Të ardhura	543,275	3,534,620	2,045,628	2,096,279	2,123,588	3,808,155
Të ardhura nga paga e subjektit	228,840	976,421	980,038	994,980	986,339	1,095,029
Të ardhura nga paga babai i subjektit		1,378,973		49,390		1,486,980
Të ardhura nga paga / pensioni nwna e subjektit	164,466	567,964	411,957	297,418	302,474	302,868
Të ardhura nga paga vllai I subjektit	149,969	611,262	653,633	754,491	834,775	923,278
E) Shpenzime	189,942	958,831	872,711	1,014,498	1,524,788	1,255,242
Shpenzime minimale jetike	151,218	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit Ermal Tauzi	38,724	131,337	236,955	127,500	304,207	71,693
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit J.T	-	6,986	-	-	13,765	13,527
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit E.T	-	146,706	-	7,006	309,713	200,200
Shpenzime për këste kredie E. T		70,581	33,323			29,454
Shpenzime për këste kredie Ermal Tauzi		39,125	38,337			
Balanca e fondeve (D-C-E)	396,190	2,628,055	608,165	1,694,158	715,076	1,705,649